



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.07.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për deklarinimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}”.
- “Për deklarinimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:52 dhe mbaroi në orën 13:51.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

10. Yllka Rupa (anëtare)

11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. Të pranishëm në sallë dy ish-anëtarët e Këshillit, të cilëve u mbaroi mandati, z. {...} dhe znj. {...}.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}”.

- “Për deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”.

Naureda Llagami: Atëherë përshëndetje të gjithëve!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 29 korrik 2024.

Në fakt siç jeni në dijeni, ne sot në këtë mbledhje kemi shqyrtimin e të gjithë projektvendimeve për magjistratët që kemi për të emëruar, pra 32 projekt-aktet, por duke marrë parasysh që nga ana e Kuvendit u zgjodhën dy anëtarët e rinj të cilët do jenë në

2

Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe zëvendësojnë dy anëtarët nga radhët e avokatisë, konkretisht z. {...} dhe znj. {...}, atëherë në rendin e ditës kemi përfshirë edhe mbarimin e mandateve të dy kolegëve tanë, të z. {...} dhe znj. {...}, duke ftuar dhe dy anëtarët e rinj, vendimi i të cilëve është botuar në fletoren zyrtare në datë 26 korrik 2024. Kështu që ky është projekt-akti i parë që unë jua kam vënë në dispozicion.

Më lejoni që në emrin tuaj t’i them mirëseardhjen dy kolegëve dhe shpresoj që me të dy kolegët, ju të paktën si Këshill, duke qenë se edhe unë jam në procesin e zëvendësimit, të keni të njëjtën gjuhë komunikimi dhe të punoni në të njëjtën mënyrë siç kemi punuar edhe ne, Këshilli i mëparshëm. Gjithashtu gjej rastin që të falënderoj në fakt të dy kolegët tanë, z. {...} dhe znj. {...} për punën shumë të mirë dhe për kontributin që kanë dhënë që nga dita një e krijimit të këtij institucioni dhe deri në ditën e fundit të tij duke punuar me përkushtim dhe duke bërë të mundur që ky institucion sot të jetë një institucion i cili është pa diskutim një nga më të mirët në institucionet e sistemit të drejtësisë.

Kështu që unë në fakt i uroj dhe i them faleminderit për kontributin dhe i uroj suksese në angazhimet e tjera që ato do kenë.

Ftoj anëtarët për të votuar mbi çështjen e parë që është deklarimi i mbarimit të mandatit dhe përfundimi i qëndrimit në detyrë për z. {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord dhe i uroj mbarësi në jetën e mëtejshme.

Bledar Bajri: Jemi dakord me pikën e parë të rendit të ditës. Mbarësi në vazhdim. Faleminderit që na pritën këtu.

Albens Tabaku: Po dakord, pro, duke i falënderuar për kontributin që kanë dhënë gjatë kësaj kohe dhe duke menduar që të vazhdojnë më tutje detyrën që ata kanë lënë.

Markelian Koça: Dakord. Suksese në vazhdim.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord. Edhe dy fjalë nëse mundem për kolegët që u mbaron mandati edhe për kolegët e rinj që vijnë në detyrën e re. Fillimisht unë dua të shpreh

vlerësimin, mirënjohjen, falënderimin, për zotin {...} dhe zonjën {...} si kandidatë me të cilët ne kemi ndarë gjatë kësaj kohe përafërsisht dy vjet e gjysmë, saç kam unë këtu në këtë detyrë, momente të mira, momente të këqija, momente gëzimi, momente ndonjëherë zhgënjimi, por që të gjitha këto momente mbeten në memorie dhe në kujtesën tonë si pjesë e një kontributi jashtëzakonisht të mirë që kanë dhënë dy kolegët tanë dhe që mbetet si pjesë, si gurë kilometrik i punës së vazhdueshme të Këshillit nga e shkuara në të ardhmen. Kështu që në këtë aspekt unë e kam një cikë të vështirë për t'i lidhur fjalitë njëra me tjetrën por përfundimisht dua t'i them kolegëve, t'i uroj suksese, mbarësi, dhe t'i siguroj që ata kanë lënë të paktën tek unë personalisht një përshtypje jashtëzakonisht të mirë e cila nuk do të shlyhet ndonjëherë nga kujtesa ime.

Njëkohësisht kolegëve të rinj që kanë ardhur sot për herë të parë i uroj suksese, mbarësi, me krahë të lehta dhe me këmbë të mbarë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit Klodi!

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...}.

2. Përfundimi i qëndrimit në detyrë të z. {...} më datë 26.07.2024.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim projekt-aktin tjetër që është i njëjti projekt-akt por që ka të bëjë për zonjën {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Duke falënderuar përsëri zonjën {...} për kontributin edhe për fjalët e mira që dëgjuam nga kolegët.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}.

2. Përfundimi i qëndrimit në detyrë të znj. {...} më datë 26.07.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot për të lejuar Këshillin të vijojë shqyrtimin e çështjeve me dyer të mbyllura.

Faleminderit!

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor